

INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE I STANDARDEVE

PROGRAMI MËSIMOR
LËNDA: GJUHË ITALIANE

(klasa e shtatë)

Tiranë, 2005

PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

- I. HYRJE
- II. SYNIMET EDUKATIVE DHE OBJEKTIVAT DIDAKTIKË
- III. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT DHE E VETËVLERËSIMIT
- IV. PËRSHKRIMI I AFTËSIVE GJUHËSORE
- V. STRUKTURA ANALITIKE E PROGRAMIT
 - AKTET / FUNKSIONET KOMUNIKUESE
 - TEMATIKA
 - STRUKTURAT GRAMATIKORE
- VI. UDHËZIME DIDAKTIKE
- VII. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT
- VIII. KRITERET PER HARTIMIN E TEKSTIT

I. Hyrje

Integrimi i vendit tonë në gjirin e familjes evropiane kërkon edhe njohjen dhe zotërim të efektshëm të gjuhëve të huaja. Në këtë kuadër, mësimi i gjuhës italiane në arsimin e detyruar do t'u krijojë mundësi nxënësve të arrijnë shpejt një autonomi të përdorimit të kësaj gjuhe nëpërmjet mjeteve të përshtatshme për një komunikim imediat.

Ky program nënkupton drejtimin, mbështetjen dhe nxitjen e nxënësit me nevojën për t'u përshtatur, për t'u shprehur e për të komunikuar në mjedise të ndryshme.

Në kuadrin e ndryshimeve të sistemit shkollor (shtrirja e arsimit të detyruar nga 8 në 9-vjeçar), plani mësimor i gjuhës italiane në klasën VII, përmban 2 orë javore. Duke pasur parasysh moshën e nxënësit, në program është bërë përshtatja e kësaj grup-moshe me tematikën, objektivat, aktet dhe funksionet komunikuese.

Programi i klasës së shtatë mbështetet në njohuritë dhe aftësitë e përfituara nga nxënësit në klasat paraardhëse, duke i zgjeruar dhe duke i thelluar ato. Synimet dhe objektivat didaktikë të paraqitura në këtë program janë bazuar mbi programin e klasave (III – VI), duke i riparë dhe ridimensionuar.

Në përgatitjen e këtij programi, autorët janë mbështetur në nivelet dhe përcaktimet e bëra në “Vizionit kurrikular” (ISP, 2004), rekomandimeve të Kurrikulës kombëtare të gjuhëve moderne (MASH, 1999), si dhe Kuadrit të përbashkët të referencave të Këshillit të Evropës (Strasburg, 1998).

II Synimet edukative dhe objektivat didaktikë

Duke e konsideruar gjuhën si një:

- mjet të të menduarit (gjë që nënkupton kryerjen e operacioneve mendore);
 - mjet për të vendosur një marrëdhënie shoqërore (që nënkupton një bashkëveprim ndërmjet folësve);
 - mjet të shprehjes dhe trashëgimit të përvojës (që realizon një ndërveprim social-edukativ);
 - mjet të shprehjes së ndjenjave, të gjendjes shpirtërore (që nënkupton përmasat e saj estetike);
 - mjet për shprehjen e kulturës (rolin e saj historik, shoqëror, mjedisor etj);
- mësimdhënia/nxënia e gjuhës së huaj (italishtes) parashtron, përgjithësisht, këto synime edukative dhe objektiva didaktikë:

a. Synime edukative

Mësimdhënia/nxënia e gjuhës italiane:

- i shërben formimit të përgjithshëm të nxënësit;
- zgjeron aftësitë shprehëse të nxënësit;
- ofron modele sjelljeje/qëndrimi në situata të caktuara mësimore;
- ndihmon përfshirjen e nxënësit në shkëmbime të shumëllojshme.

Së bashku me gjuhën italiane, nxënësit marrin informacion edhe për kulturën pjesë e së cilës është vetë gjuha. Roli kulturor është një komponent shumë i rëndësishëm, që ndikon në arritjen e kompetencës komunikuese. Pra nxënësi mëson rregullat e mirësjelljes, normat shoqërore, respektin kundrejt tjetrit.

Mësimi i gjuhës italiane si gjuhë e huaj është njëkohësisht edhe proces njohjeje i kulturës/qytetërimit kombëtar, përkatësisht edhe kulturës/qytetërimit italian dhe, si i tillë, bën të mundur zgjerimin e aftësive formuese, kulturore dhe njohëse të personalitetit të nxënësit duke ndihmuar kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë në formimin e personalitetit të

tij, në përfshirjen e tij në një ndërveprim socialkulturor më të gjerë përmes marrëdhëniesh ndërpersonale dhe sociale;

Mësimdhënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj në shkollën 9-vjeçare synon zhvillimin e proceseve konjitive, trajnimin e mendjes, krijimin e aftësive njohëse dhe krijuese; mbi të gjitha, ajo synon t'i pajisë nxënësit me strategji individuale nxënëse (*way of learning*).

b. Objektiva didaktikë

Ashtu si dhe për katër klasat parardhëse, mësimnxënia e gjuhës italiane si gjuhë e huaj parashikon gërshetimin e katër aftësive tradicionale bazë (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit e të shkruarit).

Duke mbajtur parasysh ngritjen cilësore në zhvillimin e përgjithshëm të kësaj grup-moshe në këtë cikël më të lartë, pra edhe nevojat dhe interesin për një zgjerim e thellim të mëtejshëm të aftësive gjuhësore e komunikuese krahasuar me ciklin fillor e klasën e gjashtë, synohet zhvillimi i aftësisë së të kuptuarit dhe të krijuarit, me shkrim dhe me gojë, përmes një shkëmbimi bashkëveprues të dy apo më shumë aftësive njëherësh, në varësi të mundësive, kushteve dhe objektivave konkretë.

Në formë të përgjithësuar, objektivat didaktikë do të përmbledhin:

Objektivi komunikues

Lehtësia me të cilën njerëzit në një mjedis të huaj e mësojnë gjuhën e atij mjedisi, argumentohet në një pjesë të mirë të saj me faktin se fjalët dhe strukturat përvetësohen gjatë kryerjes së një veprimi të gjallë, më shumë sesa duke lexuar a studiuar me/në libra/kurse gjuhe. Prandaj ka rëndësi të mësuarit aktiv të gjuhës së huaj në shkollë.

Në klasën e shtatë, një vend të rëndësishëm zë edhe arësyetimi. Mësuesi i gjuhës italiane e ndërton dhe përpunon lëndën mësimore, e përshtat atë në situata të ndryshme që ta bëjë më të lehtë për nxënësin, duke krijuar hapësira komunikuese të ngjashme me ato të jetës së përditshme.

Objektivi gjuhësor

Në këtë fazë, fillojnë e nguliten rregulla dhe dalëngadalë ngrihet skeleti, ndarjet dhe riorganizimi i gjuhës italiane. Nxënësi fillon të ndërgjegjësohet për ligjshmërinë gjuhësore, ndërkohë që mësuesi i ofron situatat a kontekstet e përshtatshme që bëjnë të mundur përdorimin e këtyre strukturave.

Përdorimi në mënyrë të saktë i një strukture gjuhësore shkakton te nxënësi një lloj sigurie: ai ndërgjegjësohet, arrin vetë të kuptojë se ç'është e rregullt dhe jo e rregullt. Njohuritë gjuhësore kanë tani një rëndësi krejt tjetër ndaj të folurit spontan në krahasim me ndjesitë gjuhësore të nivelit fillestar.

Objektivi socialkulturor

Strukturat gramatikore dhe elementet leksikore përvetësohen më mirë të vendosura në kontekste përdorimi. Integrimi i elementeve të qytetërimit në mësimin e gjuhës italiane shton motivimin e nxënësve, duke i çuar ata në një realitet tjetër të ndryshëm nga ai ku jeton, duke u ngjallur interesim, kërkëri për vendin fqinj, për gjuhën, zakonet, ritet, normat e ndryshme të jetesës, duke zgjeruar kështu edhe njohuritë e kulturën vetjake të përgjithshme.

III. Vlerësimi dhe vetëvlerësimi

Vlerësimi i nxënësit realizon matjen e përparimit dhe të arritjeve në gjuhën italiane. Megjithë karakterin shpesh subjektiv, kontrolli gojor në fillim të çdo ore mësimi është një element i rëndësishëm për të vlerësuar çka është mësuar më parë. Një pedagogjie të diferencuar i korrespondon një vlerësim i diferencuar, që i mundëson secilit nxënës të dallojë përparimin e vet, cilido qoftë niveli i arritur.

Njohja dhe vlerësimi i arritjeve dhe mangësive të nxënësve bëhet duke i dëgjuar ata kur flasin dhe lexojnë ose duke vëzhguar të shkruarit e tyre. Të aftësosh nxënësin që ata t'i përgatitin vetë pyetjet për t'ua drejtuar nxënësve të tjerë, është një ushtrim me vlerë për zhvillimin e aftësisë komunikuese.

Vlerësimi formues vë në dukje rendimentin që nxënësi ka arritur në përvetësimin e programit si dhe ndihmën që jep mësuesi për shmangien e gabimeve.

Vlerësimi përmbledhës bëhet në fund të një numri të caktuar temash, kapitujsh, në fund të semestrit apo të vitit. Ai bëhet në përputhje me objektivat mësimorë. Është e rëndësishme që nxënësi të nxitet drejt vetëvlerësimit, që ai të ndërgjegjësohet për rezultatet e punës së vet.

Me synimin për të siguruar një vlerësim efektiv të procesit mësimor, të pikënisjes dhe të pikëmbërritjes, të vështirësive të hasura, si edhe të masave të ndërmarra, mësuesit të mbledhin në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme informacion lidhur me zhvillimin dhe asimilimin e njohurive dhe të aftësive, lidhur me gatishmërinë ndaj të nxënësve, lidhur me shkallën e ndërgjegjësimin për çdo nxënës.

Informacionet të mbledhen në mënyrë sintetike që të bëjnë të mundur një ballafaqim të nivelit të përparimit individual dhe kolektiv, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së marrë në shqyrtim. P.sh., aftësitë me shkrim duhet të vlerësohen përmes veprimtarive të tilla, si: shkrimi i fjalëve të veçuara apo frazave të shkurtra, plotësimi i vendeve bosh brenda fjalëve apo frazave të shkurtra, përmes batutave të shpeshta në një dialog të shkurtër, mesazheve të urimit, listave të thjeshta me emra rrobesh, ushqimesh, sendes të klasës apo të shtëpisë etj.

IV Përshkrimi i aftësive gjuhësore (performanca gjuhësore)

1. Të dëgjuarit

Nxënësi:

-tregon se kupton tekste të gjuhës së folur lidhur me tema të njohura për të, me tema të gjuhës familjare dhe jofamiljare e që kanë të bëjnë me ngjarje të shkuara, të tashme e të ardhme;

-është në gjendje të kuptojë gjuhën e folur me shpejtësi mesatare në çdo rrethanë;

-përcakton dhe vëren pikat kryesore në një tekst të thjeshtë, është në gjendje të dallojë edhe detaje të veçanta, me ndihmën edhe të ndonjë përsëritjeje;

-dallon dhe përcakton thelbin në ndonjë lajm për ndodhi të ndryshme të njoftimeve televizive ku shoqërohen me figurë dhe komente të shkruara.

-ndjek bisedat e përditshme të artikuluar qartë që i drejtohen atij dhe shpesh kërkon përsëritje të fjalëve dhe shprehjeve të veçanta.

Arritja e aftësisë në dëgjim do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë

A. *Dialogjesh* që lidhen me:

-situata në familje, në mjedisin shkollor, në mjedise publike (dyqan, bar etj.),

-situata me lojërat dhe kohën e lirë,

-informacione për shkollën, familjen, argëtimin etj.,

B. *Monologjesh* që lidhen me:

-lajmërimet shkollorë të shkurtra, njoftime të shkurtra radiotelevizive, mesazhe të shkurtra.

2. Të folurit

Nxënësi:

-komunikon me ndihmën e disa shprehjeve të thjeshta ose disa frazave të mësuara më parë, si dhe improvizon me fraza të shkurtra;

-zotëron një fjalor të mjaftueshëm për të përballuar situata të komunikimit të përditshëm;

-merr pjesë në bashkëbisedime të shkurtra, duke kërkuar e vjelë informacione dhe mendime, duke përdorur terma të thjeshtë që kanë të bëjnë me përvoja të shkuara, të tashme apo dhe me projekte të së ardhmes, me veprimtari dhe me interesa që i përkasin jetës së përditshme;

-diskuton me dikë për çka do të bëjë dhe ku do të shkojë, lë orën dhe vendin e takimit;

-i drejtohet dikujt për një informacion dhe tregon kur e kupton ose jo atë;

-përballon disa situata në të cilat ndodhet gjatë një udhëtimi në vendin ku flitet gjuha italiane për të plotësuar nevojat e veta;

-di të bëjë një përshkrim të njerëzve, të rrethanave jetësore, të veprimtarisë së përditshme, të asaj që i pëlqen apo jo me fjali të thjeshta;

-bën pyetje të thjeshta dhe përgjigjet, merr nisativën në të folur dhe reagon ndaj pohimesh të thjeshta që lidhen me nevoja imediate apo me çështje të njohura për të;

-komunikon në veprimtari të thjeshta, në të cilat kërkohet një shkëmbim i thjeshtë informacioni rreth çështjesh të njohura që lidhen me familjen, shkollën, lojën dhe kohën e lirë;

-hyn dhe merr pjesë në biseda të të shkurtra ku kërkon informacion dhe bën veprime të thjeshta në mjedise të njohura (dyqan, shkollë, postë, bibliotekë etj.).

Arritja e aftësisë së të folurit do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste apo veprimtari në formë:

A. *Monologjesh* në të cilat:

-di të flasë për veten, familjen, miqtë, vende, persona etj.;

-flet për mësimet, për kohën e lire, pasionet, zakonet vetjake;

-përshkruan një përvojë të caktuar.

B. *Mashkëveprimi* me mësuesin/nxënësit për tema të njohura;

-*role-play* të thjeshtë në të cilët riprodhohen situata të njohura (dyqan, lokal, shkollë, bibliotekë, stacion etj.).

3. Të lexuarit

Nxënësi:

-gjen dhe kupton informacionin apo faktet e kërkuara, p.sh., kush, ku, kur është kryer diçka etj.;

-kupton informacionet më të rëndësishme në broshura të shkurtra, të thjeshta me informacion rreth jetës së përditshme;

-kupton tekste në të cilat është përdorur një gjuhë e përdorimit të përditshëm.

Arritja e aftësisë në të lexuar do të realizohet nëpërmjet materialesh gjuhësore që u propozojnë nxënësve tekste, si:

-kartolina, letra, mesazhe sms,

-fletëpalosje, tabela apo reklama,

-lajmërimë, udhëzime të thjeshta (rregulla ushtrimi, lojë etj.),

-paralajmërimë rreziku,

-orare (shkolle, mjetesh transporti, mjedisesh sportive etj.),

-histori të shkurtra.

4. Të shkruarit

Nxënësi:

-shkruan struktura të thjeshta duke gabuar herë pas here, si, p.sh., në përdorimin e kohëve të foljeve, por jep zakonisht qartë atë çka përpiqet të shprehë;

-shkruan hartime të shkurtra duke përdorur fjalorin për tema të njohura;

-përshkruan motin, stinët;

-krijon mikrodialogje;

-përdor fjalorin për gjetjen dhe memorizimin e termave që nuk njih;

-kërkon dhe jep informacione me shkrim, në kartolina e letra të thjeshta;

-përshkruan njerëz, vende, veprimtari të përditshme, atë që i pëlqen apo jo, përmes frazash të thjeshta.

Arritja e aftësisë në të shkruar realizohet nëpërmjet materialesh të shkruara, si:

-module apo formularë (shkolle, biblioteke etj.),

-kartolina, letra, mesazhe sms,

-lajmërimë në një kënd lajmërimësh apo në gazeta për fëmijë.

V Struktura analitike e programit

1 Aktet / funksionet komunikuese

Nxënësit të ushtrojnë e të përvetësojnë një sërë funksionesh apo aktesh komunikuese që, duke patur parasysh grup-moshën, nevojat dhe interesat e tyre, si edhe objektivat edukativo-mësimorë të ciklit të mesëm të ulët do të jenë në gjendje:

- të ndjekin udhëzime;

-të pyesin, të përgjigjen dhe të japin shpjegime;

-të nisin dhe të zhvillojnë një bashkëbisedim, një bisedë telefonike;

-të shprehin miratim, refuzim, ndjesi dhe opinione vetjake;

-të kërkojnë dhe të japin informacion;

-të shprehin pëlqime dhe reagime;

-të paraqiten e të paraqesin të tjerët;

- të pyesin e të përgjigjen për gjeneralitetet (emër, mbiemër, kombësi, shtetësi, moshë, vendbanim, adresë, numër telefoni etj.);
- të pyesin e të përgjigjen për profesionin e të afërmve;
- të përshëndetin e t'u përgjigjen përshëndetjeve;
- të pyesin e të japin mendim për persona, objekte, sende dhe vende;
- të bëjnë ftesa, propozime, t'i pranojnë apo t'i refuzojnë ato;
- të pyesin e të përgjigjen për çka dinë të bëjnë (gjuhët, sportet, hobet etj.);
- të shprehin kënaqësi apo moskënaqësi, qëllime apo synime;
- të tregojnë fakte në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen;
- të bëjnë krahasime
- të shprehin pëlqim apo mospëlqim, nevoja apo dëshira;
- të kërkojnë e të thonë vendndodhjen e objekteve të ndryshme;
- të kërkojnë e të porositin diçka në dyqan në supermarket, në zyrat publike;
- të pyesin për çmimin dhe vlerën;
- të hapin, të vazhdojnë e të mbyllin një bisedë telefonike;
- të shkruajnë mesazhe personale, si edhe letra me karakter informal dhe formal.

2 Tematika dhe leksiku

Përmbajtja tematike e programit të klasës VII është rimarrje e asaj që është trajtuar në ciklin fillor dhe në klasën VI, por në formë më të pasuruar e më të thelluar në planin leksikor, gramatikor, komunikues.

Fusha tematike është përzgjedhur duke u mbështetur në “Vizionin kurrikular të lëndës së gjuhëve të huaja”, si dhe në Kuadrin e përbashkët të referencave të Këshillit të Evropës.

a. Tematika

Rimerren pjesa më e madhe e temave dhe çështjeve të trajtuara në katër nivelet pararendëse (klasa III-VI) që lidhen me interesat dhe nevojat e kësaj moshe, në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia e përmbajtjes, por në formë më të zgjeruar.

1. Jeta e përditshme:

- familja, të afërmit, marrëdhëniet familjare, ndarja e detyrave në familje;
- kafshët shtëpiake, cilat janë kafshët shtëpiake, qeni, macja etj.;
- festat familjare, organizimi i festës, tavolina, dhurata, ëmbëlsira, veshja sipas stinëve dhe rasteve speciale, pazaret;
- shokët dhe shoqet e lagjes, marrëdhënia me to;
- koha e lirë dhe hobet, lojërat, pasionet, librat etj.;
- ditët, muajt, datat, orët;
- shtëpia, mjediset e brendshme, objektet apo sendet në të, llojet e banesave.

2. Jeta shkollore:

- shkolla, klasa, objektet përreth, orari, mësuesit, drejtuesit, marrëdhëniet me ta ;
- shokët dhe shoqet e grupit, marrëdhëniet me ta;
- personeli i shkollës, marrëdhëniet me të ;
- një ditë në shkollë;
- lëndët mësimore dhe preferencat lëndore, lënda e re dhe mendime për lëndën;
- përcaktimi i veprimtarive (lexim, shkrim);
- librat dhe biblioteka, llojet e gjinive aventuresk, shkencor etj;
- numrat dhe veprimet aritmetike.

3. Vetja dhe të tjerët:

- shëndeti, sëmundjet, llojet e sëmundjeve, vizitë tek mjeku;
- trupi, higjiena, njohja me rregullat e higjienës;
- mënyra e të veshurit, prirjet, moda;
- karakteristika të shokëve dhe të popullit italian;
- popujt dhe pamja e tyre e jashtme (momente ndërkulturore);
- miqësi të reja, në plazh, në chat, me e-mail etj

4.Mjedisi rrethues:

- qyteti, shtetet, kontinentet;
- koha, moti, stinët, klima;
- adresa, mjetet e transportit e të telekomunikacionit, tv, radio, sms, cel, e-mail;
- udhëtimet e bëra apo që dëshirohet të bëhen;
- vende takimi dhe argëtimi, monumente arti e historike;
- monedha, dyqane, tregu;
- zyrat publike, bashkia dhe personeli, posta dhe punonjësit, gjendja civile etj.

5.Bota telematike:

- programe radio-televizive të ndjekura;
- herojtë dhe personazhet e filmave vizatimorë për fëmijë, si, p.sh., Shrek, Hirushja, Borëbardha, Piter Pan;
- korrespondenca elektronike me miqtë, kompiuter, sms.

6.Lojërat dhe sporti:

- lojërat, sporti, garat; llojet e lojërave, si ato kompiuterike;
- veshjet e pajisjet sportive

7.Tregime, përshkrime vendesh e ngjarjesh.

b. Leksiku

Përzgjedhja e teksteve bazohet mbi një repertor leksikor, pjesa më e madhe e të cilave i përket fjalorit bazë të gjuhës italiane, ndërsa pjesa tjetër lidhet me fusha dhe kontekste përdorimi të veçanta për grup-moshën.

3. Elemente dhe struktura gramatikore

a- Morfosintaksa

Strukturat e parashikuara synojnë të nxisin aftësinë komunikuese të nxënësve duke aktivizuar funksionet komunikuese minimale. Këto janë strukturat më të përdorshme që bëjnë të mundur realizimin e komunikimit në një nivel minimal brenda fushës tematike të përzgjedhur;

Niveli i nxënësve paramendon zotërimin e këtyre strukturave morfosintaksore:

- gjinia dhe numri i emrave të rregullt e të parregullt;
- mbiemrat cilësorë, shkallët e krahasimit, forma të veçanta të tyre; mbiemrat në shkallën sipërore, veçoritë e tyre;
- zgjedhimi vepror i foljeve të rregullta në mënyrat dhe kohët e mëposhtme, format vetvetore a përemrore:
 - a.indicativo (presente, passato prossimo, imperfetto, futuro anteriore, trapassato prossimo),
 - b.urdhërore, urdhërore me trajtat përemrore,
 - c.përcjellore (stare + përcjellore),
 - d.forma e mirësjelljes me kushtore;

- të pacaktuarit (shembuj) dhe lidhorët;
- parafjalë të thjeshta dhe të përbëra;
- kundrinorët e drejtë dhe të zhdrejtë;
- frazë e thjeshtë: fjali dëftore, pyetëse, habitore, urdhërore;
- frazë të shkurtra me bashkërenditje e nënrenditje;
- struktura pyetëse (chi, quando, come, dove, quale, perché);
- folje të parregullta në tre kohët bazë.

b. Fonetika

Fonetika ka për qëllim t'i aftësojë nxënësit për një shqiptim të saktë të fjalëve dhe fjalive me intonacionin dhe muzikalitetin e duhur

VI. Udhëzime didaktike

Në hartimin e kurrikulës së re të gjuhës italiane mësuesi është i lirë të zgjedhë metodën që gjykon si më të përshtatshme në kushtet e klasës në të cilën punon, mjaft që të përmbushë programin dhe objektivat e parashikuara.

Nxënësve t'u krijohet mundësia për të marrë pjesë në veprimtari në të cilat ndërthuren dy apo më shumë aftësi gjuhësore, për të përdorur gjuhën për qëllime reale, për të vënë në zbatim aftësitë e tyre.

Një mundësi me karakter metodologjik lidhet me parimin sipas të cilit nuk mund të realizohet të nxënit pa pjesëmarrjen aktive të nxënësit. Për të nxitur këtë pjesëmarrje, të përdoren veprimtari në të cilat të ndërfitet sa më shumë të jetë e mundshme nxënësi.

Për të ngjallur motivimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve, duhen përdorur sa më gjerësisht teknikat e dramatizimit, role-play etj., të cilat bëjnë të mundshme një përfshirje fizike dhe emotive të nxënësit në veprimtari në grup e në çifte dhe i krijojnë mundësi atij të dalë jashtë mjedisit shkollor, duke shkarkuar tensione, frustrime e duke shmangur filtrin afektiv bllokues, si edhe të nxjerrë në pah personalitetin e vet. Dramatizimi e role-play i krijojnë mundësi pjesëmarrjeje përmes dialogjeve në shkëmbime me karakter komunikues, të cilat lypin kryerjen e një roli të caktuar në një mjedis të përcaktuar; ato bëjnë të mundur përdorimin e disa kanaleve shprehëse për komunikimin: gjuhën, veprimin, gjestin.

Në metodat e reja komunikuese nxënësi gjen vetveten dhe është më i lirshëm për t'u shprehur. Rekomandohet puna në grup, mbasi informacioni përgatitet nga të gjithë dhe përgjegjësi për suksesin apo mosp suksesin u takon të gjithëve dhe kjo i ndihmon që të ndjehen të bashkuar dhe njësoj të vlerësuar.

Për t'i nxitur nxënësit të shprehën, të komunikojnë duke zhvilluar dhe duke ushtruar aftësitë e tyre potenciale, është e nevojshme kryerja e veprimtarive shprehëse-krijuese-reflektuese-analizuese. Për këtë nevojitet:

-Së pari, t'u jepet nxënësve një input më i zgjeruar, nocione dhe njohuri të reja, më të zgjeruara, më të plota e më të thella se ato të fituara në vitet e mëparshme;

-Së dyti, të nxiten nxënësit të reflektojnë për materialin didaktiko-edukativ që u jepet;

-Së treti, të nxiten ata të diskutojnë, të debatojnë (përmes përdorimit të gjuhës italiane). Si siguri për të arritur suksesin në punën tonë si mësues do të shërbejë pjesëmarrja e nxënësve në veprimtari komunikuese, në shkëmbime, të cilat çojnë më pas në rritjen e motivimit dhe në nxitjen e të shprehurit, prej nga kalohet drejt një procesi analize, pjekurie dhe mendimi kritik nga ana e nxënësve.

Për shpjegimet e ndryshme, si edhe për paraqitjen e veprimtarive praktike, mësuesi të përdorë një gjuhë të qartë e të kuptueshme, një ritëm normal, një shqiptim të dallueshëm e të qartë.

Roli i mësuesit ndryshon. Ai tani luan një rol mbështetës dhe nxitës të veprimtarive individuale dhe autonome të nxënësve. Mësuesi nxit dhe krijon situata mësimore reale.

Gjatë veprimtarive në klasë, mësuesi duhet të përpiqet të përdorë sa më shumë që të jetë e mundshme gjuhën italishte. Sidoqoftë, për të shmangur raste moskuptimi që nuk do të lejonin zhvillimin e një veprimtarie të caktuar në mënyrën e duhur, do të përdoret edhe gjuha amtare.

Pas paraqitjes së veprimtarisë apo lojës, të fjalëve apo strukturave të reja, mësuesi, nga roli fillimisht i aktorit të mënjanohet e të kalojë në atë të regjizorit që drejton aktorët (nxënësit), duke i nxitur ata e duke dhënë *input*-e apo skena të reja.

Gjuha e përdorur në klasë është ajo bashkëkohore, në formën, ritmin dhe intonacionin e vet autentik;

Llojshmëria e teknikave didaktike do të bëjë të mundur që të gjithë nxënësit të përfitojnë duke patur parasysh faktin se aftësitë e tyre nuk janë të njëjta apo të barabarta. Lipset që në punën me grupe apo skuadra mësuesi të përpiqet të sigurojë pjesëmarrjen e të gjithë nxënësve duke i nxitur të shprehen lirisht.

Reflektimi gjuhësor duhet të jetë:

-induktiv dhe konkret (është nxënësi ai që, duke ndjekur mënyrën induktive, zbulon rregullën përmes veprimtarish konkrete gjuhësore);

-i paraqitur në formë veprimtarie apo problemi për zgjidhje, i tillë që t'i nxisë nxënësit të vënë në përdorim aftësitë e veta vëzhguese;

-jo i bazuar mbi një metodologji të përqendruar në shpjegimin e rregullës nga mësuesi, por që synon në zbulimin e saj nga vetë nxënësit natyrisht i ndihmuar edhe nga mësuesi.

Vëzhgimet sistematike të kryera nga ana e mësuesve gjatë procesit mësimor përbëjnë një mjet të favorshëm për përmirësimin e vazhdueshëm të programit, duke u dhënë mundësinë që të përfshijnë në kohën dhe vendin e duhur ato përmirësime apo plotësime që ata i gjykojnë të nevojshme. Kur niveli i nxënësve, për arsye e shkaqe të ndryshme, del më i lartë se ai i përcaktuar në këtë kurrikul, atëherë, për të mos shkaktuar demotivim, dhe për të shmangur monotoninë, mësuesi mund të propozojë e t'u paraqesë nxënësve të tij materiale të tjera gjuhësore, të zgjedhura e të përgatitura nga vetë ai, duke i integruar me materialin e tekstit të gatshëm, duke ndjekur udhëzimet e mëposhtme:

-të sigurojë natyrshmërinë e gjuhës së paraqitur;

-të sigurojë përshtatshmërinë e gjuhës me situatën dialogjike;

-të kufizojë strukturat dhe leksikon e ri të paraqitur;

-të ketë parasysh që gjatësia e tekstit të dhënë të jetë e mjaftueshme për kontekstualizimin e formave të reja që të bëhet kështu i mundur një kuptim dhe një dramatizim i thjeshtë i tekstit;

-të paraqesë një farë shkalle interesi për nxënësit;

-të përdorë mjete vizive ndihmëse (objekte, pamje, fotografi, revista etj., kur i mungojnë aparaturat tv), të cilët e bëjnë të qartë kontekstin e dialogut dhe e lehtësojnë kuptimin global të materialit të paraqitur.

VII. Struktura sintetike e programit

35 javë x 2 orë = 70 orë

Përsëritje në fillim të vitit	4 orë
Mësime të reja	54 orë
Përsëritje gjatë vitit	4 orë
Detyra me shkrim	4 orë
Mësime të pavarura	2 orë
Biseda të lira	2 orë
<i>Gjithsej</i>	70 orë

Përsëritje në fillim të vitit (4 orë). Në klasën VII, përsëritja në fillim të vitit ka për qëllim rifreskimin e njohurive bazë leksikore dhe gramatikore të marra gjatë vitit paraardhës dhe mbi të cilat do të mbështeten njohuritë e reja të këtij viti shkollor. Përzgjedhja i lihet mësuesit në varësi të nevojave të nxënësve.

Mësime të reja (54 orë). Mësuesi është i lirë që të planifikojë vetë mësimin, numrin e orëve që nevojiten për secilën njësi didaktike në varësi të nivelit të klasës ku jep mësim.

Përsëritje gjatë vitit (4 orë). Ka për qëllim ngulitjen e strukturave më të rëndësishme gramatikore dhe të leksikut, si dhe përdorimin e tyre në situata të tjera.

Detyra me shkrim (4 orë). Detyrat me shkrim nuk kanë qëllim vetëm një vlerësim të njohurive, por krijojnë kushte që nxënësi të ndërgjegjësohet për arritjet dhe mangësitë e veta, me qëllim që të ndërtojë punën për mënjanimin e tyre.

Lexime të pavarura (2 orë). Përdorimi i pjesëve letrare nuk është vetëm një veprimtari e mirëpritur dhe një bashkëbisedim i këndshëm, larg mësimin tradicional, por dhe mjeti i duhur për të motivuar si në të folur, ashtu edhe në të shkruar. Rekomandohen tregime me figura, mbasi ato u afrohen më tepër tipareve të moshës së nxënësit dhe janë më të thjeshta për t'u kuptuar e për t'u komentuar.

Biseda të lira (2 orë). Mësuesi përzgjedh tema (që kanë të bëjnë kryesisht me kulturën/qytetërimin italian), të cilat ua propozon nxënësve për diskutim në klasë. Përmes tyre bëhet i mundshëm ndërgjegjësimi lidhur me pasuritë dhe diversitetin e kulturave të dy popujve tanë, nxitet komunikimi dhe shkëmbimi i mendimeve të vetë nxënësve në gjuhën italiane.

VIII. Kriteret për hartimin e tekstit

Për hartimin e tekstit duhet mbajtur parasysh grup-mosha së cilës i drejtohet, si dhe sasia e orëve në të cilat do të shtrihet ai:

- përcaktimi i objektivave gjuhësorë në mënyrë të qartë;
- teksti të jetë i ndarë në njësi didaktike;
- tematika e zgjedhur të jetë sa më afër interesave të ; ajo duhet t'i përmbahet tematikës së propozuar në program;
- të ketë materiale autentike, me ilustrime kryesisht me ngjyra;
- të ngërthejë strategji ndërvepruese për të zhvilluar tek nxënësit: “unë di të bëj”, “unë di të jem”;
- gramatika të jetë e ndërthurur me objektivat komunikues;
- të mbajë parasysh zhvillimin e personalitetit të nxënësit, reagimin e tij emocional;
- të ketë format të madh që të lehtësojë pamjen e leximin;
- të ketë ushtrime për zhvillimin e imagjinatës, lidhjen ndërlëndore (histori, gjeografi etj.);
- të ketë një baraspeshë ndërmjet veprimtarive individuale dhe kolektive;
- metoda e përdorur të shoqërohet me kasetë dhe me libër mësuesi.

Teksti të jetë me katër ngjyra.

Teksti të ketë 150 faqe A4

Formati të jetë 260 x 200 mm.